



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d) dhe të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 dt. 2008”), nenit 12. të Ligjit nr. 04/L-097 për Bibliotekat, nenit 5. të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL. Nr. 0203 – 76, të datës 24.01.2013, dhe Nenit 8, paragrafi 1, nenit 9, paragrafi 1, pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 -8103 datë: 29. Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, pas procedurës së diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 janar 2015, miraton:

## **STATUTIN E BIBLIOTEKËS “AZEM SHKRELI” PEJË**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Qëllimi**

##### **Neni 1.**

- i. Me këtë statut rregullohet statusi juridik i bibliotekës “Azem Shkreli” në Pejë (në tekstin e mëtejme biblioteka), veprimtaria e bibliotekës, organizimi, përfaqësimi, planifikimi, buxheti dhe transparenca.

##### **Neni 2.**

- i. Biblioteka është një ndër institucionet qendrore të kulturës në komunë dhe ka për qëllim t’i shërbejë zhvillimit letrar dhe kulturor të qytetarëve me anë të librit, shtypit ditor dhe periodik, internetit etj.
- ii. Biblioteka është qendra më e rëndësishme për grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e librit. Është qendër metodike për krejt rrjetin e bibliotekave të komunës.

##### **Neni 3.**

- i. Për realizimin e qëllimit, të drejtave dhe përgjegjësive që i takojnë, biblioteka vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për bibliotekat, politikave programore të DKRS- së, sektorit të kulturës, dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës në Pejë.

## STATUSI JURIDIK I BIBLIOTEKËS

### Neni 4.

- ii. Biblioteka e Pejës daton nga viti 1836, Në vitin 2000 emërtohet biblioteka “Azem Shkreli”.

### Neni 5.

- iii. Selia e bibliotekës “Azem Shkreli” është në Pejë, në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës, rruga “Enver Hadri”.

### Neni 6.

- i. Biblioteka ka status të institucionit kulturor publik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës në Pejë
- ii. Pasuria e bibliotekës është pronë e komunës.
- iii. Në ballinën hyrëse të objektit të bibliotekës vendoset mbishkrimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhët zyrtare, të cilat parashihen me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

### Neni 7.

- i. Biblioteka “Azem Shkreli” ka xhirollogarinë e vet në njërin prej bankave të licencuara në Kosovë, pas aprovimit të këtij statuti.

### Neni 8.

- i. Biblioteka ka vulën e rumbullakët dhe vulën katrore, e cila përdoret për protokollimin e shkresave zyrtare.
- ii. Vula e rumbullakët është me diametër 4 cm, në 3 rathë koncentrikë dhe përmban këto të dhëna:
  - a) Në rrethin e parë, të jashtëm, shkruhet: *Republika e Kosovës,*
  - b) Në Rrethin e dytë shkruhet *Komuna e Pejës, Pejë*
  - c) Në rrethin e tretë shkruhet: *Biblioteka “Azem Shkreli”*,
  - d) Në sipërfaqen e mbetur, brenda rrethit të tret të vulës, vendoset libri i hapur.
  - e) Teksti i vulës është me shkronja të mëdha shtypi, në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Kosovës.
- iii. Vula katrore e protokollit është e madhësisë 6 x2.5 cm, me këtë përmbajtje, sipas renditjes

- a) *Republika e Kosovës,*
  - b) *Komuna e Pejës,*
  - c) *Biblioteka “Azem Shkreli”,*
  - d) *Numri i protokollit i njësisë organizative, në vazhdim lihet hapësirë për shënimin e numrit të protokollit të shkresës.*
- iv. Biblioteka mund të ketë edhe vula të tjera, përmbajtja dhe forma e të cilave caktohet me vendime të veçanta të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sport, të cilat rekomandohen nga sektori i kulturës.

## VEPRIMTARIA E BIBLIOTEKËS

### Funksionet dhe detyrat e bibliotekës

#### Neni 9.

- i. Biblioteka është institucion kulturor dhe informues, që nxit të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjerimin e dijes dhe interesin për lexim në rajonin, ku ajo zhvillon veprimtarinë e saj.
- ii. Biblioteka siguron qasje të lirë në dije e informacion dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.
- iii. Biblioteka është institucion kyç për koleksionim, ruajtjen dhe propagandimin e kulturës në Pejë.
- iv. Biblioteka grumbullon materialin bibliotekar të formateve të ndryshme nga të gjitha shkencat e dijës, regjistrimi, përpunimi, sistemimi, ruajtja, mirëmbajtja dhe ofrimi për shfrytëzim i përdoruesve dhe digjitalizimi i materialeve ekzistuese dhe atyre të reja për shfrytëzim me anë të internetit.
- v. Biblioteka krijon katalog dhe siguron informacione të materialeve bibliotekare me karakter historik, kulturor dhe shkencor.
- vi. Koleksionet e bibliotekës, me materiale në shqip dhe në gjuhët e huaja, krijohen nëpërmjet blerjes, shkëmbimit dhe dhuratave. Komuna, me anë të DKRS-së, rekomanduar nga sektori i kulturës, në bazë të mundësive financiare, çdo vit ndan mjete buxhetore për pasurimin e fondit librar me literaturë në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e huaja.
- vii. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sektori i kulturës, është përgjegjëse që të gjitha materialet e sesioneve shkencore, simpoziumeve, historikë të ndryshëm për qytetin dhe rrethinën të depozitohen në bibliotekë.
- viii. Biblioteka, sipas nevojës, mund të themelojë degët e veta në lokalitete sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore, të cilat rekomandohen nga DKRS.
- ix. Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, biblioteka ka të drejtë të ketë marrëdhënie bibliotekare me bibliotekat e komunave të tjera, me bibliotekën kombëtare “Pjetër Budi” në Prishtinë, me qëllim bashkëpunimi në këtë fushë për

- dhënien e ndihmës njëra-tjetrës dhe plotësimin e veprimtarisë me koleksione, huazime dhe falje të materialeve bibliotekare.
- x. Biblioteka e përfshirë në cilëndo formë të bashkëpunimit ndërkomunal ose me bibliotekën kombëtare “Pjetër Budi” në Prishtinë, veç e veç ose bashkërisht, mban përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet juridike, të cilat i re realizojnë nga bashkëpunimi në fjalë.

#### **Neni 10.**

Në kuadër të bibliotekës zhvillohen edhe këto veprimtari:

- i. Koordinimi i punëve profesionale të degëve brenda territorit të Komunës së Pejës, duke e ndarë fondin e librave dhe koleksioneve bibliotekare proporcionalisht, bazuar në kërkesat e lexuesve.
- ii. Ofrimi i qasjes në materialet bibliotekare për të gjithë shfrytëzuesit e saj brenda territorit të komunës edhe më gjerë.
- iii. Bashkëpunimi në përpilimin e katalogut të elektronik me bibliotekën kombëtare “Pjetër Budi” në Prishtinë dhe ofrimin e tij në dispozicion të përdoruesve.
- iv. Përpos bashkëpunimit me bibliotekat e tjera në komuna të Kosovës, bashkëpunon edhe me bibliotekat ndërkombëtare.
- v. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative në ambientet e bibliotekës, siç janë ekspozitat e librit, promovime, tribuna, takime me krijues orët letrare dhe veprimtari e tjera bibliotekare.
- vi. Bashkëpunimi me institucionet kulturore, shtëpitë botuese, shkollat universitet dhe komunitetin, me qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- vii. Prezantimi i shërbimeve dhe veprimtarive të saj për publikun përmes ueb-faqes, katalogëve, fletushkave e formave radio dhe TV emisioneve dhe formave të tjera të informimit.
- viii. Përpilimi dhe botimi i publikimeve profesionale, si: katalogë, doracakë, fletëpalosje, revista etj., në pajtim me Ligjin mbi bibliotekat.
- ix. Në koordinim me sektorin e kulturës të DKRS-së harton projekte e programe për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të degëve bibliotekare.
- x. Huazimi dhe këmbimi i materialeve bibliotekare për t’i përmbushur nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve.
- xi. Mbledhja e informacioneve dhe materialeve brenda territorit të komunës, të cilat i ruan dhe i ofron në shërbim të përdoruesve.
- xii. Shfrytëzimi i literaturës së digjitalizuar, bazuar në teknologjinë e hapur.
- xiii. Ushtrimi edhe i veprimtarive të tjera në pajtim me ligjin, me këtë statut dhe me politikat zhvillimore të sektorit të kulturës në DKRS.

### **Neni 11.**

- i. Shërbimet që u behën lexuesve janë me pagesë.
- ii. Llojet e shërbimeve me pagës, tarifat për shërbimet e veçanta, si dhe gjobat për moskthimin e librit dhe literaturës në afat apo për moskthim fare ose humbje, miratohet nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të DKRS-së

## **ORGANET E BIBLIOTEKËS**

### **Neni 12.**

- i. Organet e bibliotekës janë:
  - a) Drejtori,
  - b) Kolegjiumi profesional dhe
  - c) Këshilli i bibliotekës.

### **Neni 13.**

Drejtori ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- i. Drejtori i bibliotekës udhëheq, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë dhe funksionimin e bibliotekës, në bazë të përshkrimit të detyrave në punë, ligjit dhe këtij statuti.
- ii. Përfaqëson bibliotekën brenda dhe jashtë vendit,
- iii. Harton dhe aprovon strategjitë dhe politikat zhvillimore të bibliotekës,
- iv. Harton planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar,
- v. I raporton DKRS-së për përmbushjen, e planit vjetor të punës dhe lidhur me financat e bibliotekës.
- vi. Inicion ndryshimet e Statutit me rekomandim të DKRS-së
- vii. Nxjerr rregulloren e brendshme të punës e cila duhet të aprovohet nga drejtori i DKRS-së
- viii. Propozon politikat zhvillimore të bibliotekës dhe politikat për mbështetje financiare,
- ix. Organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime për punë kualitative.

### **Neni 14.**

- i. Drejtori i bibliotekës zgjidhet në bazë të procedurave të konkursit publik të parapara me ligjet përkatëse në fuqi.
- ii. Në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, mund të shkarkohet edhe para periudhës për të cilën është emëruar.

**Neni 15.**  
**Këshilli i bibliotekës**

- i. Drejtori i bibliotekës, në konsultim DKRS-në cakton Këshillin e Bibliotekës, në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarësh, për periudhën 3-vjeçare. Këshilli përbëhet nga radhët e punonjësve të bibliotekës, si dhe nga radhët e veprimtarëve të kulturës, të arsimit dhe të shkencës jashtë këtij institucioni.
- ii. Në Këshill të Bibliotekës përfshihen edhe anëtarë nga radhët e nxënësve dhe studentëve-lexues të bibliotekës.
- iii. Këshilli i Bibliotekës:
  - a) Jep këshilla, mendime dhe sugjerime për organizimin, veprimtarinë dhe shërbimet bibliotekare,
  - b) Mbron vlerat kulturore në përputhje me Ligjin për bibliotekat, Ligjin për institucionet e kulturës, me këtë statut dhe me aktet e tjera, të nxjerra nga DKRS,
  - c) Shqyrton planin dhe raportin e punës dhe
  - d) Propozon ndryshime në Statut dhe ndryshime në akteve të tjera.

**Neni 16.**  
**Kolegjiumi profesional**

- i. Kolegjiumi profesional përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen nga drejtori, në konsultim paraprak me DKRS-n, në mandat 3-vjeçar.
- ii. Kolegjiumin profesional e përbëjnë anëtarët e degëve të bibliotekës dhe sektori i kulturës në DKRS.
- iii. Kolegjiumi profesional është organ profesional këshillëdhënës i drejtorit të bibliotekës;
  - a) Shqyrton planin vjetor dhe raportin vjetor të punës, si dhe planin financiar dhe raportin financiar,
  - b) Jep propozime për aftësimin profesional të punonjësve të bibliotekës dhe
  - c) Bashkëvepron në përpilimin e punimeve profesionale, të cilat i boton biblioteka.

**PËRFAQËSIMI**

**Neni 17.**

- i. Bibliotekën e prezanton drejtori i saj. Në pamundësi të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të drejtorit, atë mund ta zëvendësojë personi, të cilin e cakton drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me këtë rast, ai ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e drejtorit.

## FINANCIMI I BIBLIOTEKËS

### Neni 18.

- i. Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë së bibliotekës i siguron:
  - a) Buxheti i komunës,
  - b) Të ardhurat nga anëtarësimi i shfrytëzuesve të shërbimeve bibliotekare në bibliotekë,
  - c) Të ardhurat nga donacionet, fondacionet, bizneset, OJQ-të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj, nga shërbimet me pagesë, të cilat do të shfrytëzohen për pasurimin e fondit të koleksioneve dhe librave të bibliotekës dhe nga
  - d) Burimet e tjera të parapara me ligj, me aktet e tjera nënligjore dhe me këtë statut.

## PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

### Neni 19.

- i. Biblioteka harton planin vjetor të punës dhe raportin për punën e bërë. Plani i punës dhe raporti i punës për çdo vit propozohen nga Këshilli i Bibliotekës, pas dhënies së pëlqimit nga sektori i kulturës i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### Neni 20.

- i. Biblioteka planin e punës e harton në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar, vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga Biblioteka dhe në pajtim me politikat zhvillimore të DKRS-së.

## NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

### Neni 21.

- i. Njoftimi i punonjësve bëhet:
  - a) Me anë të publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të bibliotekës dhe
  - b) Me kërkesat e secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkuara, lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tij.

**Neni 22.**  
**Transparenca dhe sekreti zyrtar**

- i. Puna e bibliotekës është transparente për publikun;
- ii. Transparenca për punën në bibliotekë realizohet me anë të:
- iii. Prezantimit para publikut të interesuar dhe mediave,
- iv. Organizimit të ekspozitave dhe
- v. Bashkëpunimit me individë, institucione dhe organizata të kulturës, arsimit dhe të shkencës.

**Neni 23.**

- i. Drejtori i bibliotekës është i autorizuar që të njoftojë me shkrim dhe me shtyp, radio dhe TV për çështjet që kanë të bëjnë me punën e bibliotekës.

**Neni 24.**  
**Sekreti zyrtar**

- i. Sekret zyrtar në Bibliotekë është dokumentacioni dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Bibliotekës, DKRS-së dhe të Komunës në përgjithësi.
- ii. Sekret zyrtar do të trajtohet dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me Vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës së Pejës.

**MBROJTJA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE**

**Neni 25.**

- i. Për realizimin e të drejtave të punonjësve të bibliotekës, ata do t'i drejtohen eprorit (drejtorit) të bibliotekës dhe drejtorit të DKRS-së,
- ii. Ndaj vendimit të marrë nga drejtori i bibliotekës, dhe drejtori i DKRS-së ushtrohet ankesë në Komisionin për ankesa të Komunës së Pejës, ose drejtpërdrejt të Kryetari i Komunës.

**AKTET E BIBLIOTEKËS**

**Neni 26.**

- i. Në bazë të Statutit të Bibliotekës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, biblioteka, me lejin e DKRS-së, miraton rregullore dhe vendime, me të cilat më saktësisht rregullohet veprimtaria e bibliotekës dhe të drejtat e punonjësve të këtij



institucioni, të cilat nuk duhet të jenë në kundërshtim me Ligjin mbi bibliotekat, Ligjin mbi shërbyesit civilë, Ligjin e punës, si dhe Statutin e Kuvendit të Komunës.

- ii. Aktet e caktuara nga pika 1. e këtij neni, duhet të nxirren në afat prej 3 muajsh, nga dita e hyrës në fuqi të këtij statuti.
- iii. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të bibliotekës.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 27.

- i. Nga hyrja në fuqi e këtij statuti, pushojnë të vlejnë statuti dhe aktet e tjera të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij statuti.

### Neni 28.

- i. Ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

**01.Numer: 400 - 78751**

**Pejë, datë: 30 Janar 2015**

### KUVENDI KOMUNAL PEJË



**KRYESUESI,**  
**Dr. Islam Husaj**